



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prudato Received/Delivery	01.07.2022	2	viti god year
Organ/Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasra Kolicina Quantity
SKANSHTK	3873	2022	17



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.502/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtar dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 04.06.2021 me numër A.nr.502/2021, të parashtruar nga grup ankuesish të përfaqësuar nga Avokati Qendrim Rama, sipas Aktgjykimit Anr.1834/2021 të datës 11.05.2022 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, për ankuesit

me adresë,
në Komunë të Skenderajt, në çështjen juridike “Kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.502/2021 e datës 04.06.2021 e parashtruar nga ankuesit,
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesit,** të përfshirë në grupin e ankuesve në ankesë me numër A.nr.502/2021 të datës 04.06.2021.

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Policinë e Kosovës me datën 16.04.2021 dhe me datën 21.04.2021, kanë parashtruar kërkesë për Drejtorin e Personelit në Policinë e Kosovës, për mes përfaqësuesit të autorizuar avokatit Qendrim Rama, me pretendime ankimore për kompensimin e pagës jubilarë (10 vite) dhe pagën së 13-të, sipas nenit 3 nenit 29

Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Drejtori i Personelit në Policinë e Kosovës me datën 07.05.2021 dhe me datën 12.05.2021 ju është përgjigjur ankuesve lidhur me kërkesat e parashtruara.

Ankuesit të pakënaqur me pa kënaqur në përgjigjen e datës 07.05.2021 dhe përgjigjen e datës 12.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Personelit në Policinë e Kosovës në Prishtinë, kanë parashtruar ankesë me datë 04.06.2021 me numër protokollit 2877/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit me pretendime ankimore për kompensimin e pagës jubilarë (10 vite) dhe pagën së 13-të, sipas nenit 3 nenit 29 Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.06.2021, ankesën e ankueseve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 21.06.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë nga 1/33 faqe.

Këshilli më datë 16.07.2021 përmes shkresës me numër të protokollit 3782/2021, ka njoftuar ankuesit për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 04.06.2021 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 11.05.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1834/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve.

dhe ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së e datës 19.05.2020 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësve të datës 04.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimi me numër Anr.1834/2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 16.07.2021 me numër protokollit 3782/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Flete kthesa e datës 23.07.2021 e pranuar nga përfaqësuesi i autorizuar avokati Ankesë e ankuesve me shkresat e bashkangjitura, ankesa A.nr.502/2021 me numër protokollit 2877/2021 të datës 04.06.2021; Përgjigje e datës 07.05.2021 nr.01/0354 në Kërkesë për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë); Përgjigje e datës 07.05.2021 nr.01/0377 në Kërkesë për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë); Përgjigje e datës 12.05.2021 nr.01/03594 në Kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë; Kërkesë e datës 05.05.2021; Vërtetim i punës i datës 25.03.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/360/2021; Kërkesë e datës 16.05.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës, për i datës 19.01.2021, Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 30.12.2019, Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 31.12.2018; Autorizim i datës 01.04.2021 për Avokatin Kërkesë e datës 29.04.2021 për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë) nga Vërtetim i punës i datës 24.03.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/303/2021 me Formular për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 19.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 31.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 26.12.2018; Autorizim i datës 23.04.2021 për

Avokatin Kërkesë e datës 05.05.2021 për kompensimin e pagës jubilarë nga Vërtetim i punës i datës 25.03.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/364/2021; Kërkesë e datës 16.04.2021 për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë) nga Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 18.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 24.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 31.12.2018; Autorizim i datës 05.05.2021 për Avokatin Vërtetim i punës i datës 25.03.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/389/2021; Kërkesë e datës 16.04.2021 për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë) nga Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 19.01.2021, Formulari i përfundimit të punës, i datës 31.12.2018, Autorizim i datës 08.04.2021, Kërkesë e datës 05.05.2021 për kompensimin e pagës Jubilarë nga Vërtetim i punës i datës 19.04.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/609/2021; Kërkesë e datës 21.04.2021 për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë) nga Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 18.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 31.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 27.12.2018; Autorizim i datës 20.04.2021; Kërkesë e datës 05.05.2021 për kompensimin e pagës Jubilarë nga Vërtetim i punës i datës 25.03.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/367/2021 nga Kërkesë e datës 21.04.2021 për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë) nga Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 19.01.2021 për Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 30.12.2019 për Autorizim i datës 23.03.2021; Kërkesë e datës 05.05.2021 për kompensimin e pagës Jubilarë nga Vërtetim i punës i datës 19.04.2021 Nr.ref.04/1-02SRR/0285/2019; Kërkesë e datës 16.04.2021 për kompensimin e pagës së 13-të(trembëdhjetë) nga Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 19.01.2021 për Formular i vlerësimit të përfundimit të punës i datës 30.12.2019; Formular i vlerësimit të përfundimit të punës i datës 20.12.2018; Autorizim i datës 23.03.2021;Përgjigje në ankesë e datës 21.06.2021; E-mail i datës 15.06.2021; Kontratë e punës e datës 28.10.2004 - Kontratë e punës së datës 18.06.2004 Kontratë e punës së datës 16.01.2006 - Kontratë e punës së datës 02.08.2004 - Kontratë e punës së datës 02.08.2004 Kontratë e punës së datës 19.09.2004, Kontratë e punës së datës 16.05.2005. E-mail i datës 22.04.2021 dhe i datës 20.04.2021; Përgjigje e datës 07.05.2021 me numër protokollit 01/0354 në kërkesë për kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë); Përgjigje e datës 07.05.2021 me numër protokollit 01/0377 në kërkesë për kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë); E-mail zyrtarë i datës 29.07.2021 nga Njësia e personelit, lidhur me pagesën jubilarë për ankuesit dhe me shkresat e bashkangjitura ¼6 faqe, nga Drejtoria për buxhet dhe financa për të dhënat e shpërblimeve jubilarë. Lista e pagës e datës 29.02.2016, Vendimi i datës 11.02.2016 dhe Lista e pagës e datës 29.02.2016.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesve, dhe
Bajrami, është e pa bazuar, kurse për ankuesit, dhe
 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent për të vendosur, SEPSE:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e pagën jubilarë (10 vite) dhe pagës së 13-të për tri vitet e fundit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për periudhën nga viti 2018, 2019 dhe 2020, për ankuesit si në vijim:

i punësuar në vendin e punës "Nëpunës-Zyrtar në MTO dhe Logjistik", në Stacionin /Njësia: Stacioni Policor në Skenderaj- Drejtoria Rajonale e Policisë, Mitrovicë të Jugut, sipas Kontratës së punës së datës 16.01.2006, i punësuar në vendin e punës "Asistent Administrativ", në Stacionin/Njësia: Stacioni Policor në Skenderaj-Sektori i Operatives-stacioni Policor Skenderaj -Drejtorja Rajonale Mitrovicë Jugut, sipas Kontratës së punës të datës 19.09.2004, i punësuar në vendin e punës "Radio komunikues dhe baza e të dhënave", në Stacionin /Njësia: Stacioni Policor në Skenderaj-Sektori i Operatives-Qendra e Komunikimit, Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Jugut, sipas Kontratës së punës së datës 18.06.2004 dhe i punësuar në vendin e punës "Radio komunikues dhe baza e të dhënave", në Stacionin /Njësia: Stacioni Policor në Skenderaj-Sektori i Operatives-Qendra e Komunikimit, Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Jugut, sipas Kontratës së punës së datës 16.05.2005, konstaton se në bazë të provave të lëndës dhe konform nenit 03 paragrafit 5 të Ligjit Nr.03/149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatuar ky ligji, stafi civil në Policinë e Kosovës i është nënshtruar për veç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave ligjore të ligjit të veçantë , gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Po ashtu, duke u bazuar në Kontratën e punës të datës 18.06.2004 dhe të datës 16.05.2005, që mbajnë pozitë: "Radio komunikues dhe baza e të dhënave", në Stacionin /Njësia: Stacioni Policor në Skenderaj-Sektori i Operatives-Qendra e Komunikimit, Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Jugut, për ankuesit dhe Kolegji ka konstatuar se dhe pozita Radio komunikues, hyn në kategorinë e pozitave të nëpunësve civil, bazuar në deklarinimin e statusit të zyrtarit publik i konfirmuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik sipas Aktgjykimit nr.KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese i publikuar me datën 13.07.2020, si dhe hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik i publikuar me datë 21.08.2020.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë së ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 05.05.2021 dhe me datë 16.04.2021 i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Personelit në Policinë e Kosovës, për kompensimin pagës jubilarë (10 vite) dhe pagën së 13-të për tri vitet e fundit, pagën jubilarë, sipas nenit 3 nenit 29 Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës,

Drejtori për Personel dhe Administratë i Policisë së Kosovës, me datë 07.05.2021, në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 05.05.2021 ka njoftuar të njëjtin së refuzohet kërkesa sa i përket kompensimit të pagës jubilarë (10 vite) dhe pagës së trembëdhjetë 13-të për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore ndërsa sa i përket pagesës së pagës jubilarë kjo pagesë është kryer nga Policia e Kosovës në muajin dhjetor 2014 dhe shkurt 2016 për 10 vite përvojë pune.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar

përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: ... 2.Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione..., 3.Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet e pensionit; 4.Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe beneficionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtarët policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesve për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, prej tri viteve të fundit 2018/2020 të ankesave, duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, kurse me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Neni 20 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar kompensimet e nëpunësve civil përtej pagës, duke paraparë se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit; 8 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës; 2.2. shpenzimet e shkaktuara me rastin e shfrytëzimit të automjetit personal për punë zyrtare; 2.3. shpenzimet e shkaktuara gjatë punës në terren; 2.4. shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se stafi civil në Policinë e Kosovës, mund të realizoj vetëm kompensimet përtej pagës të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më datë 09.07.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativitetin të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke i referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e pagën jubilarë (10 vite) dhe pagës së 13-të për tri vitet e fundit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020, **edhe për ankuesit,** që mbanë pozitë "Mbështetëse", sipas Kontratës së punës së datës 28.10.2004, dhe që mbajnë pozitën "Pastrues" me Kontratë të punës të datës 02.08.2004, në Stacionin /Njësia: Stacioni Policor në Skenderaj-Sektori i Resurseve/Zyra për Shërbime Mbështetëse, Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Jugore, lidhur me kompetencën lëndore Këshilli ka konstatuar se **nuk është kompetent për të vendosur për ankesat e ankuesve** dhe në bazë të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të parashtruar me datë 04.06.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër Anr.502/2021 e protokolluar me nr. 2877/2021.

Bazuar në kontratat e punës të ankuesve si dhe në përshkrim të detyrave të punës, është konstatuar se hyjnë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, të cilët nuk kanë statusin e nëpunësve të shërbimit civil, sipas dispozitave ligjore të nenit 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: **"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"**.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesit kanë statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *nuk është kompetent për të vendosur*, lidhur me grupin e ankuesve të tjerë si: _____ dhe _____ të përfshirë në grupin e ankuesve sipas ankesës me numër A.nr.502/2021 të datës 04.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ka konstatuar se marrëdhëniet e punës e nëpunësve administrativë dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës dhe sipas nenit 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtarët publikë me status të nëpunësve administrativo-teknikë dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontestin administrativ në gjykatën kompetente, siç e përcakton dispozita ligjore për mbrojtjen e nëpunësve të shërbimit publik në nenin 74 paragrafi 1 dhe 5 në pjesën e V-të, të këtij ligji, citoj: "1. Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës.....", dhe paragrafi 5 " 5. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.502/2021, datë 01.07.2022

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.